

## Leje Kalimi për të mitur

### Përshkrimi

Pajisja me Leje Kalimi për fëmijë të mitur, që nuk kanë dokument të vlefshëm udhëtimi (humbur ose dëmtuar) ose të bebove të lindura jashtë vendi dhe që dëshirojnë të vijnë ose kthehen në Shqipëri.

### Dokumentacioni i nevojshëm

- 1) Kërkesë e prindërve të të miturve ose
- 2) E njërit prind, me pëlqimin e prindit tjetër. Pëlqimi jepet nëpërmjet një deklarate me shkrim, e mbështetur në dokumente konfirmuese ose nëpërmjet një deklarate noteriale.
- 3) Për të miturin me një prind ose me kujdestar, kësaj kërkesë i bashkëlidhen dokumente që konfirmojnë kujdestarinë mbi fëmijën.
- 4) Pasaportë e pavlefshme / kartë identiteti origjinale / certifikatë lindje nga gjendja civile përkatëse, e lëshuar jo më larg se 3 muajt e fundit nga data e kërkesës, e shoqëruar me kopjen e kartës së identitetit;
- 5) Denoncimi pranë autoriteteve kompetente vendase për humbjen e pasaportës;
- 6) Për bebe të lindura në spitalet jashtë vendi, kërkohet akti i lindjes i spitalit i certifikuar (apostilim ose legalizim) dhe i përkthyer
- 7) 2 foto të të miturit me përmasa 4x5 cm, dhe me sfond të bardhë;
- 8) Mandat pagesa me bankë.

### Hapat e procedurës

- 1) Paraqitja personale e të dy prindërve dhe e të miturit ose;
- 2) Paraqitja e njërit prind dhe autorizimit noterial të palës tjetër prindërore për paraqitjen e kërkesës dhe e të miturit;
- 3) Verifikimi i dokumentacionit nga konsulli;
- 4) Verifikime të tjera, nëse shihet e nevojshme;
- 5) Plotësimi i formularit LK 1.

### Tarifa e shërbimit dhe afati

30 euro

I menjëhershëm, ose në varësi të kohës së verifikimeve të nevojshme.

### Zyra

Të gjitha përfaqësitë diplomatike dhe konsullore

### Shënime

Pagesa e tarifës së shërbimit konsullor kryhet nëpërmjet bankës.

Në rastet e bebove të lindura jashtë vendi, kur autoritetet kompetente nuk shënojnë emrin në Aktin e lindjes së spitalit, bëhet një deklaratë nga dy prindërit mbi emrin e ardhshëm të bebes.

Leja e kalimi është e vlefshme vetëm për një kalim me destinacion Shqipërinë

### Formularë të nevojshëm:

Formulari LK 1